

SIMBOLIZON



PAQË

E KËRKUAM DHE JA KU E KEMI

ERIND (15), YLBERINA (14), GENIS (14), DEA (14), ELTON (14), ARTIONA (15), ISMAJL (14),
DONJETA (15), GYNER (15)

DEMOKRACIA



Në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese, sepse ne qytetarët kemi mundësi të zgjedhim për cilën parti dëshirojmë të votojmë

Të gjithë ne kemi të drejtën të jetojmë në një shtet sovran. Aty ku mund të ndihmojnë njëri-tjetrin, mund të sillemi mirë, mund të përcjellim energji pozitive dhe mund ta duam njëri-tjetrin, pa marrë parasysh fenë, gjininë, racën, dukjen, etj. Tërë këto veprime të lartcekura i mundëson demokracia, e cila është e njohur si sistemi më i mirë i qeverisjes. Në këtë sistem, i gjithë populli gëzon të drejtat në mënyrë të barabartë.

Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. Hapat e parë të demokracisë u hodhën qysh në vitin 507 para erës sonë. Më parë, pra në fillet e demokra-

cisë, në vendimmarrje merrnin pjesë vetëm burrat dhe asnjëherë gratë, meqenëse në atë kohë, burrat gëzonin më shumë të drejta. Ata kishin të drejtë të punonin, të shkolloheshin, të merrnin pjesë në procesin zgjedhor, etj. Ndësa, gratë ishin të obliguara të kujdeseshin për fëmijët dhe të moshuarit, si dhe t'i bënin punët e shtëpisë. Por, tani gjithçka ka ndryshuar.

Çdo qytetar i cili jeton në një shtet demokratik, ka të drejtat e barabarta. Kjo nënkupton se edhe pse ne dallojmë shumë nga njëri-tjetri, të drejtat i kemi të barabarta.

Në shtetin tonë, pra në Kosovë, ka demokraci të mirëfilltë, e sidomos kur bëhet fjalë për të drejta të barabarta të qytetarëve.

Në Kuvendin e Kosovës, nuk ka vetëm deputetë burra, por ka edhe gra, e kjo na bën neve edhe më shumë ta vlerësojmë demokracinë në Kosovë.

Ne, nxënësit e klasës së IX-të, kur të bëhemi 18 vjeçarë, do të mund ta shfrytëzojmë të drejtën për të votuar për përfaqësuesit tanë të preferuar. Por, synimi ynë është që në të ardhmen edhe dikush nga ne të jetë në rolin e përfaqësuesve, si nga mesi i grave ashtu edhe nga i burrave.


Kjo ishte e tëra për sa i përket artikullit tonë për demokracinë. Edhe pse për të shkruajtur për këtë temë neve nuk na mjafton vetëm një artikull. Andaj, ne zgjedhëm që në pika të shkurtëra t'ua shpjegojmë në mënyrën tonë se si ne e shohim demokracinë.



Përfaqësuesit e ardhshëm të demokracisë

ROLI I PËRFAQËSUESVE TË SHTETIT

ERDI (14), LEART (14), BLERON (14), GURI (14), MARJAN (14), KRISTINA (14), RREZE (15), DEA (15),
ORHIDEA (14)



Ne kemi ardhur sot në Punëtorinë e Demokracisë dhe kemi diskutuar më gjerësisht për Kuvendin e Kosovës. Nëse dëshironi të mësoni edhe ju për këtë temë, atëherë vazhdoni të lexoni artikullin tonë

Përshëndetje për ju lexues. Ne sot jemi bërë gazetarë. Për shkak se kemi marrë këtë rol, ne kemi vendosur që informatat që morëm t'ua transmetojmë edhe juve. Shpresojmë që ato do t'iu pëlqejnë.

Ne sot mësuam për Kuvendin e Kosovës. Në Kuvend bëjnë pjesë 120 deputetë, të cilët zgjedhen nga populli. Këto zgjedhje quhen zgjedhje parlamentare. Deputetët me rregull zgjedhen çdo 4 vjet. Ata iu përkasin komuniteteve të ndryshme dhe të gjithë jetojnë në Kosovë. Ka disa deputetë të cilët janë shqiptarë, e disa të tjerë janë serbë, boshnjakë, goranë, romë, ashkali, turq dhe egjiptian.

Po ashtu, ata bëjnë zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, të Qeverisë, si dhe të Presidentit. Kuvendi ka tri funksione kryesore. Ato janë: funksioni legjislativ, funksioni përfaqësues dhe ai mbikëqyrës.

Kuvendi bashkëpunon gjatë gjithë kohës me Qeverinë. Kjo për shkak se njëra nga detyrat e deputetëve është të miratojnë ligje. Por, ato kanë nevojë për t'u ekzekutuar. Sipas Kushtetutës sonë, Qeveria e ka detyrën e ekzekutimit të ligjeve. Gjatë seancave plenare, Kuvendi dhe Qeveria punojnë së bashku, si dhe shkëmbejnë pyetje dhe përgjigje në mes vete.

Gjatë muajit të kaluar është miratuar ligji nga Kuvendi i Kosovës për fuqizimin e masave parandaluese në lidhje me rregullat e komunikacionit. Kjo do të thotë se nga tani, kush shkel ligjin, do të dënohet më rreptësisht se më parë. Faleminderit për leximin dhe vëmendjen tuaj.



Gazetarët e këtij artikulli dhe...



Deputetët e ardhshëm të Kuvendit

BARAZIA GJINORE NË PARTITË POLITIKE

BLERTA (15), DEBORA (14), ERJON (14), FRROK (14), KLEVIS (14), DRIJON (15)



Nga artikujt tanë, do të keni mundësi të njohoheni më shumë se çka janë partitë politike dhe cili është qëllimi i tyre

Politika është proces përmes të cilit organizohet jeta e përbashkët në një shoqëri. Në kushte të demokracisë çdo qytetar mund të marrë pjesë në këtë proces. Kjo arrihet përmes qasjes së lirë deri tek informatat të cilat kanë të bëjnë me çështje politike: përmes manifestimit të hapur të mendimeve të tyre në lidhje me çështjet publike, përmes angazhimit në shoqëri civile ose parti politike, ose përmes kandidurës në zgjedhje demokratike. Kur thamë në kushte demokratike, menduam kushtet ku qytetarët janë të lirë të vendosin vetë për të ardhmen e tyre. Ata janë të lirë të zgjedhin, por po ashtu edhe të kandidojnë. Varësisht nga nevojat dhe kërkesat e tyre, qytetarët mund t'iu bashkohen partive politike.

Çka janë partitë politike?

Partitë politike janë grupe njerëzish të cilët kanë qëllim dhe interesa pothuajse të njëjta. Partitë e para politike u paraqitën në shekullin XVIII. Ato për herë të parë janë paraqitur në Angli, e cila njëkohësisht konsiderohet si djepi i demokracisë parlamentare. Që nga ajo kohë, rëndësia e tyre veçse rritej. Duhet të theksojmë faktin se atëherë shumë të rralla ishin ato parti që në strukturat e tyre kishin edhe gra. Këtë e kishim të prishme edhe ne në vendin tonë. Pas luftës, në Kosovë filluan të formoheshin partitë, por me një përqindje

shumë të vogël të pjesëtareve gra. Ndërsa, tani përpos që është rritur numri i partive politike, po ashtu, është rritur edhe numri i grave në politikë.

Partitë politike ndahen në parlamentare dhe jo parlamentare. Njihen si parti parlamentare të gjitha ato parti që në zgjedhje kanë arritur të fitojnë një apo më shumë vende në Parlament. Ndërsa, parti jo parlamentare iu referohemi atyre partive që në zgjedhje nuk kanë arritur të fitojnë ndonjë vend në Kuvend. Në Kuvend partitë funksionojnë si pozitë dhe opozitë. Partitë politike opozitare janë ato që në Kuvend kanë numër më të vogël të deputetëve sesa partitë politike në pushtet apo pozitë.

Këto parti politike, edhe pse nuk paraqesin shumicën, marrin pjesë në Kuvend me numër të caktuar të anëtarëve të tyre. Funkcioni kryesor i partive politike opozitare është kritika e programit dhe mendimeve të partisë politike në pushtet dhe qeverisjes së saj. Partitë mendojnë edhe për mirëqenien tonë.



Gazetarët të cilët shkruan këtë artikull

BLERINA (14), GENTIANA (14), BESJANA (14), EROLIND (14)

Në artikullin paraprak kemi diskutuar më shumë për historinë dhe fakteve rreth partive politike. Në këtë faqe, do të informoheni më shumë rreth qëllimeve të partive politike



Qytetarët e Kosovës janë qytetarë me fat për sa i përket edhe këtij procesi. Numri i partive politike të cilat kandidojnë për pushtet është shumë i madh. Prandaj edhe mundësitë për të zgjedhur partinë apo kandidatët më të mirë është shumë e madhe. Këtë fat e gëzojnë vetëm qytetarët, vendi i të cilëve ka demokracinë si sistem të qeverisjes. Partitë politike kandidojnë me dëshirën që nëse fitojnë në zgjedhje, do të mund të realizojnë planet e tyre.




Partitë politike kanë parimet e tyre me të cilat funksionojnë. Në vendin tonë, asnjë parti politike nuk mohon të drejtën e fjalës së lirë. Ky është elementi veçues i partive demokratike



Një deputete e Republikës së Kosovës



Gazetarët e këtij artikulli



Vota është e lirë në demokraci

Me anë të vizatimit të kutisë, kemi dashur të tregojmë që edhe brenda partive politike zhvillohen zgjedhje. Ndryshe ato njihen si zgjedhje të brendshme, ku anëtarët e partisë A të themi, votojnë për kandidatët të cilët kanë shprehur vullnetin dhe dëshirojnë të jenë në udhëheqje të kësaj partie.

Se sa kandidatë kanë të drejtë të kandidojnë për këtë pozitë, nuk është e caktuar në mënyrë strikte. Por, as nuk mund të ketë numër shumë të madh të kandidatëve. Kjo varet nga parimet e partisë. Pas votimit të anëtarëve të asaj partie, bëhet e ditur se kush do të jetë në krye të saj. Pra, edhe brenda partisë duhet të ketë dhe ka frymë demokratike.



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-2 & IX-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë